

No. 23, Prot.  
Nr. 25.02.2022

le Depozitohet ne QKB  
Sondika. Uppjendit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE  
DREJTORIA E PRIVATIZIMIT

Nr. 3461 Prot.

Tiranë, më 22.2.2022

QRB GJISTIM

**VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

Nr. 33 datë 22.2.2022

**PËR**

**RIKONFIRMIMIN E VENDIMIT NR.13, datë 07.03.2019 TË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKIMIT ME ANË TË PËRTHITHJES SË SHOQËRISË “PETROL ALBA” SH.A. NË LIKUIDIM, ME SHOQËRINË “SHPËRNDARJA E LIBRIT SHKOLLOR” SH.A. NË LIKUIDIM”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr. 8237, datë 01.09.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare” të ndryshuar, të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe të Urdhrit nr.287, datë 25.10.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për bashkimin me shoqërinë “Petrol Alba” sh.a. në likuidim, me anë të përthithjes të shoqërisë “Shpërndarja e librit shkollor” sh.a. në likuidim”, me cilësinë e aksionarit të vetëm,

**VENDOSA:**

1. Rikonfirmimin e vendimit nr.13, datë 07.03.2017 të Asamblesë së Përgjithshme “Për miratimin e marrëveshjes së bashkimit me anë të përthithjes së shoqërisë “Petrol Alba” sh.a. në likuidim, me shoqërinë “Shpërndarja e librit shkollor” sh.a. në likuidim”.
2. Kapitali themeltar i shoqërisë përthithëse “Petrol Alba” sh.a. në likuidim, të zmadhohet me vlerën 225,452,000 lekë, që i përket kapitalit të shoqërisë së përthithur “Shpërndarja e librit shkollor” sh.a. në likuidim.



3. Kapitali themeltar i shoqërisë përthithëse “Petrol Alba” sh.a. në likuidim, të bëhet nga 2,651,973,000 lekë në 2,877,425,000 lekë e barabartë me 2,877,425 aksione me vlerë nominale 1 000 lekë secili.
4. Shoqëria “Shpërndarja e librit shkollor” sh.a. në likuidim, referuar nenit 220 të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, të ndryshuar, vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga QKB-ja, sipas seksionit V të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.
5. Ngarkohet shoqëria “Petrol Alba” sh.a. në likuidim, për kryerjen e veprimeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar dhe të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**  
**Delina IBRAHIMAJ**

